



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:295118

Datë: 23.12.2020

Numri i dokumentit: 01367726

C.nr. 692/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini me bashkëpunëtorin profesional Adnan Hajdari, në çështjen kontestimore të paditësit, N.N nga fshati Drobesh, Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson Ajvaz Islami avokat nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Vitisë, të cilën e përfaqëson Ekrem Shabani zyrtar ligjore, me objekt kontesti shpërblimi jubilar, kompensimi i ushqimit ditorë dhe udhëtimi, vlera e objektit të kontestit 2, 516.00 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 18.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** Aprovohet kërkesëpadia e paditësit N.N nga fshati Drobesh, Komuna e Vitisë, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Vitisë, detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguajë 75 % të një page bazë, respektivisht shumën e të hollave prej 315.75 Euro, ndërsa, në emër të ushqimit ditorë për periudhën prej 18.04.2017 deri me 15.12.2020, për 537 ditë pune nga 2 Euro në ditë, t'ia paguaj shumën prej 1,074.00 Euro, si dhe, 70% të biletës së trafikut urban në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën prej 18.04.2017 deri me 15.12.2020, për 537 ditë pune, shumën prej 1,127.00 Euro, të gjitha në shumën e përgjithshme prej 2,516.00 Euro, në afat prej shtatë ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.
- II.** Obligohet e paditura Komuna e Vitisë që paditësit N.N, në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguajë shumën prej 259 Euro.
- IV.** Obligohet paditësi që t'ia paguaj gjykatës taksën shtesë prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi N.N nga fshati Drobesh, Komuna e Vitisë, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me padinë e datës 23.12.2019 dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata, t'ia aprovojë kërkesëpadinë për kompensimin e 75% të një page bazë në emër të shpërblimit jubilar, shumën prej 315.75 Euro, kurse kompensimin e ushqimit ditorë nga 2 Euro në ditë, për 537 ditë pune, të llogaritur nga data 18.04.2017 deri më 11.03.2020, shumën prej 1,074.00 Euro, si dhe shpenzimet e udhëtimit 70% të biletës së udhëtimit për 537 ditë pune, shumën prej 1,127.00 Euro, duke u bazuar në nenin 35, par. 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, për shkak se për më shumë se 26 vite është në marrëdhënie pune në SHF "Hasan Aliu" në fshatin Remnik, e gjithashtu edhe për faktin se deri më tani, përkundër kërkesës para fillimit të procesit kontestimor, e paditura nuk i ka kompensuar kërkesat e paditësit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilim të padisë 104 Euro, për një seancë gjyqësore 135 Euro dhe për taksë gjyqësore 20 Euro, në shumë të përgjithshme prej 259 Euro.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit N.N, duke e cilësuar si të pa bazë ligjore për faktin se DKA-Komuna e Vitisë nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, duke theksuar se Ministria e Arsimit, si palë nënshkruese e Kontratës Kolektive, ka qenë përgjegjëse që për të siguruar buxhet shtesë për zbatimin e kësaj kontrate, andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. Për të padituren nuk ishin kontestuese pretendimet e paditësit për përvojen e punës, ditët e pranisë së tij në punë e as fakti se paditësi udhëton çdo ditë për të shkuar në punë.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Listën e pagave, Vërtetimin për përvojën e punës dhe ditët e pranisë në punë të paditësit, si dhe dy kupona fiskal: një i lëshuar nga NT “Smira Trans”, me datë 15.12.2020, dhe tjetri nga “Endriti” shpk, i datës 15.12.2020.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata e vërtetoi kërkesëpadia e paditësit N.N është e bazuar, dhe duhet të aprovohet. Nga provat materiale të administruara u vërtetua kjo gjendje faktike: Paditësi është në marrëdhënie punë te e paditura nga viti 1993, përvoja e të cilit është 26 vjet, me pagë bazë prej 421 Euro, për periudhën prej 18.04.2017 deri me 15.12.2020 ka qenë i pranishëm në punë 537 ditë, ndërsa, për të shkuar në punë udhëton në relacionin fshati Drobesh – Viti – fshati Remnik dhe anasjelltas, e çmimi i trafikut urban në dy drejtimet është 3 euro.

Fakti se paditësi, prej vitit 1993 është i punësuar në SHFMU “Hasan Aliu” në Fshatin Remnik, Komuna Viti, u vërtetua me vërtetimin mbi përvojën e punës së paditësit, datë 14.11.2019, me të cilin dëshmohet se paditësi ka 26 vite përvojë punë te e paditura, ndërsa, nga Lista e Pagave, gjykata e vërtetoi faktin se paga bazë e paditësit është 421 Euro. Fakti se paditësi, nga data 18.04.2017 ka 537 ditë të pranisë në punë, u vërtetua nga vërtetimi me numër 134/20 i datës 15.12.2020, i lëshuar nga Drejtori i shkollës.

Faktin se paditësi udhëton për në vendin e punës nga vendbanimi i tij në fshatin Drobesh, Komuna Vitisë deri në vendin e punës në fshatin Remnik dhe anasjelltas, dhe se bileta një drejtimëshe e trafikut urban është 0.50 Euro në drejtimin Drobesh – Viti, dhe 1 Euro në drejtimin Viti – Remnik, gjykata e vërtetoi përmes Kuponave Fiskal të lëshuar nga N.T “Smira Trans” në Viti dhe Kompania “Endriti” shpk Ferizaj.

Meqenëse në bazë të provave të administruara u vërtetua gjendja faktike, gjykata e obligoi të paditurën që paditësit, në emër të një page jubilarë t’ia paguaj 75 % të një page bazë në shumë prej 315.75 Euro ndërsa, në emër të ushqimit për 537 ditë, t’ia paguajë shumën prej 1, 074.00 Euro si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për në vendin e punës, 70% të biletës së trafikut urban, t’ia paguaj shumën prej 1,127.00 Euro.

Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, Gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune, ndërsa me rastin e vendosjes për kompensimin e pagës jubilarë, gjykata u bazua në nenin 35, pika 8, ku është përcaktuar se “punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit [...] për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë 75 % të një page bazë”, kurse për kompensimin e shpenzimeve për biletat e udhëtimit për në vendin e punës Gjykata u bazua në 35 pika 5, i cili ka paraparë se “punonjësit

arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.

Gjykata, me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, nuk caktoi ekspert financiar për faktin se e paditura nuk pati vërejtje në provat e administruara, andaj, llogaritja e shumave është bërë sipas matematikës së thjeshtë; 75 % e pagës bazë prej 421 Euro e nxorri shumën prej 315.75 Euro, për kompensimin e ushqimit për 537 ditë x 2 Euro e nxorri shumën prej 1, 074.00 Euro, ndërsa për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit 70% e biletës së trafikut urban për 537 ditë x 0.50 Euro, për një drejtim, në relacionin Drobesh – Viti dhe anasjelltas, pastaj çmimin e biletës prej 1 Euro në relacionin Viti – Remnik dhe anasjelltas, shumën e përgjithshme prej 1,127.00 Euro.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të cilat u gjetën si të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2 të kësaj Kontrate kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Sipas kësaj, e paditura është e lidhur me detyrimet që burojnë nga kjo kontratë.

Lidhur me taksën gjyqësore për padi, gjykata, duke u bazuar në nenin 6.2 të UA.Nr.01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, e obligoi paditësin që të paguajë shumën shtesë prej 20 Euro, duke u bazuar në nenin 12.1 të udhëzimit të lartcekur, për kërkesat në para vlera e të cilave e tejkalon shumën prej 2,500 Euro, taksa për padi është 40 Euro, andaj, paditësi u detyrua që të paguajë këtë taksë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe obligoi të njëjtën që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 259 Euro edhe atë: Për përpilimin e padisë shumën prej 104 Euro, për taksë gjyqësore shumën prej 20 Euro si dhe për një seancë gjyqësore shumën prej 135 Euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifatat e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 692/2019, datë 18.12.2020

Gjyqtari,
Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, duke llogaritur pas ditës së pranimit të këtij vendimit. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.